



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë / /2025
Nr. Dok. 202500026/27

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për sigurimin e parandalimit të aksidenteve në daljet e segmentit rrugor Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Darragjatit, Shkodër.*

Rekomandohet kryerja e veprimeve për respektimin e të drejtës së pronësisë të shkelur subjekteve, prona e të cilëve është prekur nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re), Shkodër.

Drejtuar: **Autoriteti Rrugor Shqiptar**

TIRANË

Bashkia

SHKODËR

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

TIRANË

Për dijeni: **Këshillit të Ministrave**

TIRANË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tij të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, duke marrë shkas nga publikimi në median e shkruar¹ ka iniciuar kryesisht për shqyrtim çështjen e mungesës së sinjalistikës rrugore në aksin rrugor Shkodër-Velipojë, segmenti rrugor Harku i Bërdicës-Velipojë deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re). Në këtë segment rrugor ekzistojnë 24 dalje në të dy anët e saj, dhe se, në të gjitha këto dalje, mungojnë barrierat

¹ https://www.youtube.com/watch?v=zhxgG_AvW7w
<http://www.tv1-channel.tv/2021/07/24-dalje-ne-5-km-rruge-berdica-segmenti-rrugor-rrezikshmeri-te-larte-asnje-tabele-qe-te-paralajmeroje-drejtuesit-e-mjeteve/>

bllokuese, si dhe tabelat paralajmëruese për drejtuesit e mjeteve, si masa emergjente për të parandaluar aksidentet.

Ky rekomandim ka për qëllim të adresojë çështjen në fjalë, të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe të ofrojë propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale, në përputhje me parimet e drejtësisë, barazisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si organ i pavarur dhe i paanshëm, ka për detyrë të mbrojë të drejtat dhe liritë e qytetarëve në raport me veprimet e administratës shtetërore dhe organet e tjera të pushtetit publik. Institucioni i Avokatit të Popullit, vepron si një mbikëqyrës dhe mekanizëm mbrojtës për individët, duke siguruar që ata të mos bien viktima të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe që të respektohen aktet ligjore nga ana e autoriteteve publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e vlerësuar çështjen e sigurisë rrugore në segmentin rrugor Harku i Bërdicës-Velipojë deri tek Kthesa e Daragjatit (*gjurma e re*) në cenim të jetës, shëndetit dhe pasurisë së përdoruesve të këtij segmenti rrugor, kërkon vëmendjen tuaj në trajtimin e kësaj problematike shqetësuese.

Me rastin e inicimit kryesisht për shqyrtim të kësaj çështjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer veprimtari hetimore administrative, duke kërkuar informacion dhe shpjegime Bashkisë Shkodër, Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë Vendore të Policisë, Shkodër, Institutit të Transportit, Prefektit të Qarkut Shkodër. Nga rezultatet e hetimit, AP ka vlerësuar nevojën të adresojë edhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut të cilat kanë rezultuar nga hetimi, që lidhen me mirëadministrimin apo të drejtën e pronës.

ARRSH në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 7774/1 prot, datë 07.09.2021, bën të ditur, midis të tjerave, se:

“... Segmenti rrugor Harku i Bërdicës-Kthesa e Daragjatit, është pjesë e projektit të realizuar nga FSHZH për rikonstruksionin e rrugës së Velipojës, segmentit Harku i Bërdicës-Baks. Ky projekt është realizuar në tre lote dhe segmenti Harku i Bërdicës-Kthesa e Daragjatit është pjesë e lotit 1, të këtij projekti.

Vëmë në dukje, se loti 1 i këtij projekti, ka kaluar në gjurmë të re, dhe jo sipas rrugës ekzistuese, e cila është pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar dhe administrohet nga ARRSH. Pra, aktualisht, ky segment rrugor nuk është pjesë e rrjetit rrugor kombëtar.

Nga ana tjetër, ju bëjmë me dije se, me shkresën nr. 2351 prot, datë 06.10.2020, FSHZH ka dërguar listën e objekteve në periudhë garancie, ku nuk ka asnjë të dhënë për segmentin rrugor Harku i Bërdicës-Kthesa e Daragjatit, loti 1.

Nga informacionet e specialistëve të Drejtorisë Rajonale Veriore, Shkodër, që administron segmentin rrugor kombëtar Harku i Bërdicës-Kthesa e Daragjatit, njoftohemi se ky segment rrugor pjesë e lotit 1 të projektit të FSHZH-së, ndodhet në periudhën e garancisë së defekteve. Megjithë shkresat e dërguara nga ana jonë dhe Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër, FSHZH nuk ka dërguar asnjë informacion lidhur me fillimin e periudhës së garancisë, kohëzgjatjen e saj, si dhe detyrimet e kontraktorit gjatë kësaj periudhe, për këtë segment.

Sa më sipër, situata e krijuar në segmentin Harku i Bërdicës-Kthesa e Daragjatit, nuk mund të zgjidhet nga ana jonë... “.

Me shkresën nr. 592/1 prot. datë 03.02.2023 ARRSH na bën me dije, midis të tjerave se:

“...Segmenti rrugor Harku Bërdicës – Velipojë është rikonstruktuar nga FSHZH, i ndarë në tre lote, sipas projekteve me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës së Velipojës: Segmenti Harku i Bërdicës – Baks, Loti 1, 2, 3”, Edhe gjatë periudhës së garancisë së punimeve, mirëmbajtja e segmentit rrugor është realizuar nga vetë FSHZH.

Në përfundim të periudhës së garancisë së defekteve, segmenti rrugor, Harku Bërdicës – Velipojë, i është dorëzuar Bashkisë Shkodër, megjithëse ai është pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar.

Nga FSHZH, ende sot, nuk është dorëzuar pranë ARRSH, ose Drejtorisë së Rajonit Verior, Shkodër, ndonjë inventar i aseteve të këtij segmenti rrugor, pavarësisht se ky shqetësim është ngritur disa herë me shkresat e dërguara nga Drejtorisë së Rajonit Verior, Shkodër, dhe ARRSH. Ne si institucion nuk e disponojmë projektin e rikonstruksionit të punimeve të kryera në të tre lotet e këtij segmenti rrugor...

Për përmirësimin e sigurisë rrugore në këtë segment rrugor, nga ARRSH është zbatuar projekti me objekt “Përmirësimi i pikave të zeza në akset rrugore kombëtare”, pjesë e të cilit ishin dhe dy kryqëzime të pozicionuara në segmentin rrugor kombëtar Harku Bërdicës – Velipojë. Ky projekt ka përfshirë përmirësimin e sinjalistikës horizontale, sinjalistikës vertikale, dhe element të sigurisë rrugore si barriera mbrojtëse metalike, si dhe përmirësime të gjeometrisë së rrugës. Gjithashtu, në këto dy kryqëzime problematike është realizuar ndriçimi i tyre ...”.

FSHZH në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 782/1 prot, datë 28.03.2024, bën të ditur, midis të tjerave, se

“FSHZH ka luajtur rolin e Njesisë Zbatuese në projektin për rikonstruksionin e rrugës Shkodër-Velipojë (segmenti Harku i Bërdicës-Baks). Me qëllim mbarëvajtjen e ecurisë së këtij projekti mes FSHZH dhe Bashkisë Shkodër, është nënshkruar Marrëveshja e Investimit më datë 15.08.2017, në të cilën përcaktohen detyrat e palëve të përfshira në projekt. Në këtë marrëveshje, ndër të tjera specifikohet se Bashkia Shkodër, merr përsipër mirëmbajtjen dhe funksionimin e objektit pas marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve. Gjithashtu, kjo marrëveshje përcakton se Bashkia Shkodër, ka përgjegjësi të transferojë detyrimet e veta sipas kësaj marrëveshje që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen në rast të transferimit të së drejtës së administrimit të këtij investimi në ndonjë entitet tjetër juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

Në zbatim të marrëveshjes së lartpërmendur, FSHZH në përfundim të punimeve dhe periudhës së garancisë së defekteve, më datë 13.04.2021, ka kryer inspektimin e punimeve së bashku me përfaqësues të kontraktorit, supervisorit, kolaudatorit dhe Bashkisë Shkodër, dhe është firmosur nga të gjitha palët, “Çertifikata e Marrjes Përfundimtare në Dorëzim e Objektit”. Në vijim, përgjegjësitë për mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të këtij investimi kanë kaluar tek Bashkia Shkodër.

Aktualisht duke qenë një aks nacional, rruga Shkodër-Velipojë është nën mirëmbajtje nga ARRSH”.

Bashkia Shkodër, në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 7764/1 prot, datë 25.04.2024, bën të ditur, midis të tjerave, se:

“... Me VKM nr. 600, datë 13.10.2021, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, rruga Harku i Bërdicës-Velipojë (gjurma e re), ka kaluar në pronësi të ARRSH-së. Kështu që, edhe mirëmbajtja infrastrukturore si në karregjatën e saj ashtu dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore dhe elementëve të tjerë të

infrastrukturës rrugore në këtë aks nacional është në kompetencën e entit pronar të rrugës që është ARRSH.

Ashtu siç media e ka shtruar problemin e mungesës së sinjalistikës rrugore edhe ne kemi vërejtur mangësi të theksuara që mund të bëhen shkak për mungesën e sigurisë së lëvizjes për mjetet dhe këmbësorët. Duke qenë se jemi edhe në hyrje të sezonit turistik dhe parashikohet një rritje e numrit të përdoruesve të rrugës, ARRSH duhet të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e sinjalistikës për rritjen e sigurisë së lëvizjes për mjetet dhe këmbësorët dhe përmirësimin e qarkullimit në këtë aks nacional. Nga ana jonë ofrojmë bashkëpunimin me specialistët e Bashkisë për vlerësimin e situatës në aksin Shkodër-Velipojë”.

ARRSH në vijim të përgjigjes së dhënë Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 2664/1 prot, datë 19.04.2024, bën të ditur, midis të tjerave, se:

“... By pass i Bërdicës në aksin rrugor Shkodër – Velipojë është investim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, i cili për ndërhyrje në një rrugë kombëtare që administrohet nga ARRSH, ka lidhur çuditërisht një kontratë marrëveshje me Bashkinë Shkodër, në të cilën përcaktohet që kjo e fundit merrte përsipër mirëmbajtjen dhe funksionimin e objektit, pas marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve.

Në shkresën e FSHZH bashkëngjitur kërkesës së ardhur nga ana juaj, informohemi se:

“... FSHZH në përfundim të punimeve dhe periudhës së garancisë së defekteve, më datë 13.04.2021, ka kryer inspektimin e punimeve së bashku me përfaqësues të kontraktorit, supervizorit, kolaudatorit dhe Bashkisë Shkodër, dhe është firmosur nga të gjitha palët Çertifikata e Marrjes Përfundimtare në Dorëzim e Objektit”, dokument i cili deri tani nuk ka ardhur në ARRSH si institucion i cili administron këtë aks kombëtar.

Duhet sqaruar se sipas informacioneve të marra nga FSHZH, më datë 13.04.2021, është firmosur nga palët proces verbali i marrjes përfundimtare në dorëzim vetëm për lotet 2 dhe 3”.

Siç informohemi verbalisht nga FSHZH, nga tre lotet e këtij objekti, loti 2 dhe 3 janë marrë përfundimisht në dorëzim nga Bashkia Shkodër, e cila nuk ka përcjellë asnjë dokument. Ndërsa loti 1 ka ende punime të cilat duhet të riparohet siç janë disa dëmtime të shtresave asfaltike dhe plotësim me mbrojtëse anësore metalike të hequra, dëmtuara apo të papërfunduara dhe nuk është marrë ende në dorëzim përfundimtar.

Me VKM nr. 600, datë 13.10.2021, ky segment rrugor prej 3.8 km, u përfshi në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar të ARRSH, duke zbritur gjurmën e vjetër.

Pas publikimit në fletoren zyrtare të VKM-së nr. 600 të inventarit të ri të rrjetit rrugor kombëtar, ARRSH e ka përfshirë në një kontratë mirëmbajtjeje rutinë.

Sa sipër, të ndodhur në këto kushte, duke marrë shkas edhe nga kronika televizive lidhur me dëmtimet e mbrojtëseve anësore metalike, nga ana e kompanisë së mirëmbajtjes, me qëllim mbrojtjen e përdoruesve të rrugës dhe rritjes së sigurisë rrugore, janë riparuar guardielet e dëmtuara dhe jemi në pritje të plotësimit të tyre në pjesët që mungojnë nga kompania e kontraktuar nga FSHZH.

Gjithashtu jemi në pritje edhe të dorëzimit të komplet dokumentacionit të këtij objekti nga Bashkia Shkodër”.

Më tej, ARRSH, për këtë çështje, informon dhe shpjegon me shkresën nr. 3125/1 prot, datë 03.05.2024, se:

“... Harku i Bërdicës- Velipojë, (gjurma e re) është përfshirë në inventarin e rrjetit rrugor kombëtar për t’ju nënshtruar procedurave të mirëmbajtjes, pas përfundimit të garancisë së punimeve të realizuara nga FSHZH...”.

Referuar informacionit të dhënë prej organeve si më sipërcituar, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka vijuar me kërkesë ndaj ARRSH-së, dhe Bashkisë Shkodër, për dhënie informacioni dhe shpjegimesh të mëtijshme për çështjen në fjalë.

ARRSH, në përgjigje të kërkesës, me shkresën nr. 4958/2 prot, datë 23.07.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, bën të ditur, midis të tjerave, se:

“... Përsa i përket rrugës së re të ndërtuar nga FSHZH, në segmentin Shkodër-Velipojë, ju kemi sqaruar edhe në shkresat e mëparshme, që ka ngërçe procedurale të cilat ende nuk janë zgjidhur:

- 1- FSHZH ka lidhur marrëveshje me Bashkinë Shkodër, për një rrugë e cila nuk ishte në inventar të këtij institucioni;*
- 2- Kolaudimet dhe marrja në dorëzim e loteve të kësaj rruge janë bërë nga Bashkia Shkodër, pa asnjë përfaqësues të ARRSH-së;*
- 3- Ende sot, nuk kemi asnjë dokumentacion të dorëzimit të këtyre loteve, për të cilat duhet të jemi të informuar lidhur me projektin e realizuar;*
- 4- Në mungesë të këtij dokumentacioni, nuk mund të ndërhyjmë në pjesët që mund të kenë qenë pjesë e projekteve të palëve të treta, pasi shmangim mbivendojen e kontratave;*
- 5- Në komunikimin verbal me FSHZH, informohemi se objekti është dorëzuar kohët e fundit tek Bashkia Shkodër, sipas projektit, dokumentacion të cilin ne ende nuk e disponojmë.*

*...
Bashkia Shkodër, duhet të na dorëzojë të plotë dokumentacionin e këtij objekti të cilin e ka marrë në dorëzim, dhe me grup pune të merret në dorëzim nga ana jonë pas inspektimit në vend. Si objekt i ri, i sapo përfunduar, normalisht duhet të na dorëzohet i plotësuar totalisht me elementë të sigurisë rrugore, gjë për të cilën ARRSH nuk ka se çfarë masash të marrë për përmirësimin e sigurisë. Nëse realizimi i projektit paska mungesa në elementë të sigurisë rrugore, ka qenë detyra e Bashkisë Shkodër, të kërkonte plotësimin e tyre, meqë kanë pasur një marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar me FSHZH.*

Rruga Shkodër-Velipojë është në inventarin e ARRSH, por në rastet kur ka ndërhyrje projekti nga palë të treta, ARRSH nuk mund të ndërhyjë në ato elementë të cilët janë pjesë e projektit të tyre. Defektet që lidhen me mungesë guardrelesh jashtë projektit të investimit, do të riparohen nga ana jonë. Bashkisë Shkodër, i lind e drejta që gjatë kësaj periudhe që ende ka dokumentacionin pa dorëzuar në ARRSH, të mos ngarkojë ARRSH-në me plotësimin e guardreleve por të ndjekë rrugën ligjore për denoncimin e personave të cilët i kanë dëmtuar, nëse janë vendosur nga projekti. Në momentin kur kalon dokumentacioni i dorëzimit të rrugës në ARRSH, këto hapa ndiqen nga institucioni ynë.

Sipas verifikimeve, rezulton se problem i mungesës së sinjalistikës i referohet mungesës së mbrojtëseve anësore metalike/guardreleve në vendet ku duhet të jenë sipas projektit. Kjo është pengesa që ARRSH nuk mund të vendosë guardrele në vendet e parashikuara dhe të vjelura me situacione nga projekti i FSHZH, pasi siç e theksuam edhe më lart do të kemi mbivendosje dhe pagesë 2 herë për një element.

Zgjidhja është Bashkia Shkodër, të na dorëzojë dokumentacionin e rregullt që ka për këtë objekt me të gjithë elementët e projektit.

Të inspektohet gjendja e objektit në terren me grup pune nga përfaqësues të Bashkisë dhe ARRSH-së, ku të hartohet një procesverbal mbi dorëzimin e gjendjes faktike. Nga ana e

Bashkisë Shkodër, të dorëzohet një procesverbal ku të argumentohen ndryshimet e projektit të FSHZH-së kundrejt faktit në terren, nëse ka.

Pas realizimit të këtyre hapave, është detyrë e ARRSH-së që me kontratat e mirëmbajtjes, të ndërhyjë për përmirësimin e kushteve.

Aktualisht nga ana e ARRSH-së vijon procesi i mirëmbajtjes rutinë të objektit.

Bashkia Shkodër, në vijim të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, për informacion dhe shpjegimesh, me shkresën nr. 16106/1 prot., datë 12.08.2024, bën të ditur, midis të tjerave, se:

“Në zbatim të marrëveshjes së investimit nr. 12467 prot, datë 15.08.2017, nënshkruar mes FSHZH dhe Bashkisë Shkodër, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës së Velipojës, segmenti Harku i Bërdicës-Baks, loti 1”, me qëllim ofrimin e kushteve më të mira në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër, dhe turistëve vendas dhe të huaj që frekuentojnë plazhin e Velipojës, FSHZH ka financuar projektin dhe lot 1 është pjesë e infrastrukturës rrugore ekzistuese, por dhe një segmenti të ri të miratuar nga KKT, nr. 10, datë 16.10.2017, “Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë”, ku në rolin e zhvilluesit është FSHZH.

Në vijim me VKM nr. 600, datë 13.10.2021, “Për pronësisë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve” (ndryshuar me VKM nr. 234, datë 17.04.2024), ky segment rrugor është në inventarin e rrjetit rrugor të ARRSH.

...

Bashkëlidhur shkresës gjendet marrëveshja e investimit nr. 12467 prot, datë 15.08.2017.

...

Rruga “Harku i Bërdicës-Velipojë”, bazuar në marrëveshjen e datës 15.08.2017, ... është marrë në dorëzim nga Bashkia Shkodër, sipas certifikatës së marrjes së objektit në dorëzim nr. 901/2 prot, datë 04.06.2024 (bashkëlidhur)”.

...

Në vijim të marrëveshjes së Bashkisë Shkodër me FSHZH palët janë të vëna në dijeni në momentin e nënshkrimit të marrjes në dorëzim të punimeve, dhe duke qenë se sipas kësaj marrëveshje detyrimet e Bashkisë Shkodër janë të ezauruara mbi funksionet e saja”.

ARRSH, ka vijuar dhënien e informacionit për çështjen, me shkresën nr. 8749/1 prot, datë 03.12.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, në të cilën bën të ditur, midis të tjerave, se:

“Inventari aktual i rrugëve kombëtare që administrohet nga ARRSH, është miratuar me VKM nr. 234, datë 17.04.2024, i cili ka rifreskuar inventarin e miratuar me VKM nr. 600, datë 13.10.2021, në të cilin është përfshirë edhe segmenti Harku i Bërdicës-Velipojë (gjurma e re). Duhet të theksojmë se, në rastet kur segmentet që bëjnë pjesë në inventarin e ARRSH-së, përfshihen në projekte nga institucione të tjera, siç janë FSHZH apo bashkitë, segmenti zbritet menjëherë nga kontrata aktuale e mirëmbajtjes me qëllim shmangien e mbivendosjes së kontratave, siç kemi aktualisht p.sh. segmentin Zgosht-Ura e Cerenecit, i cili është një investim i FSHZH. Segmentet që i nënshtrohen investimeve të tilla rifuten në kontrata të mirëmbajtjes vetëm pas përfundimit të investimit, i cili njoftohet me shkresë pranë ARRSH. Një njoftim i tillë nuk ka ardhur në ARRSH...kjo vonesë ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të të gjithë punimeve të mbrojtëseve metalike nga kontraktori, i cili ka realizuar punimet por që përfundimisht është marrë në dorëzim nga Bashkia Shkodër.

Nga ana e ARRSH, duke qenë një aks i mbingarkuar me trafik, është përfshirë në një kontratë mirëmbajtje rutinë, pa ndërhyrë në elementët e projektit që mbulohen nga FSHZH.

Nga ana jonë, nuk është kërkuar më parë dokumentacion që ka të bëjë me ndërtimin e këtij segmenti rrugor pasi ARRSH nuk ka qenë as pjesë e marrëveshjes së lidhur ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Shkodër, dhe as pjesë e grupit të marrjeve në dorëzim të këtij segmenti. Së fundmi, pas komunikimit verbal me punonjësit e Bashkisë Shkodër, ju është kërkuar përcjellja e dokumentacionit përfundimtar me qëllim ngritjen e një grupi pune për marrjen në dorëzim nga ana jonë të këtij objekti”.

Po në datën 03.12.2024, me shkresën nr. 26664/1 prot, Bashkia Shkodër, bën me dije, se:

“... bazuar në marrëveshjen e datës 15.08.2017, nënshkruar mes FSHZH dhe Bashkisë Shkodër... është marrë në dorëzim nga Bashkia Shkodër objekti ... sipas çertifikatës së marrjes së objektit në dorëzim nr. 901/2 prot, datë 04.06.2024.

Prefekti i Qarkut Shkodër, në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje, me shkresën nr. 789/1 prot, datë 12.12.2024, informon se:

“... Ju njoftojmë se nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, është kontaktuar me ARRSH dhe Bashkinë Shkodër, për të plotësuar dokumentacionin e duhur, në mënyrë që ky aks rrugor të kalojë në inventarin dhe administrimin e ARRSH-së, ashtu siç e kanë përcaktuar VKM-të e sipërcituara.

Nga ndjekja e këtij problemi nga ana jonë, rezulton që Bashkia Shkodër, ka bërë plotësimin dhe dërgimin e dosjes pranë ARRSH-së”.

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 5269/1 prot, datë 23.09.2021, bën me dije, se:

“... Rruga Shkodër-Velipojë është rikonstruktuar së fundmi dhe vitin e kaluar u bë e mundur hapja e segmentit të fundit (por që në shtrirje të saj është i pari), Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit, pasi ky është segment tërësisht i ri dhe gjatë ndërtimit të saj ka pasur problematikë me shpronësimet, si dhe me pagesat që ngrinin banorët, pasi ky segment kalonte përmes tokave të tyre bujqësore dhe nuk u jepte mundësi të punonin në të gjithë pronën. Banorët e Bërdicës kanë bërë disa protesta në këtë segment për këtë problem dhe akoma nuk i është dhënë zgjidhje përfundimtare. Gjatë kryerjes së shërbimeve të policisë rrugore, deri më tani nuk kemi pasur asnjë rast të ngjarjeve rrugore të ardhura si shkak i këtyre ndërprerjeve. Sa sipër, mbetet në kompetencë të FSHZH si investitor dhe ARRSH, zgjidhja e kësaj problematike”.

Referuar informacionit dhe shpjegimeve të dhëna prej organeve të përmendura, konstatohet, se:

- Është lidhur një marrëveshje investimi për ndërtimin e infrastrukturës “Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë”, midis Bashkisë Shkodër dhe FSHZH-së, më datë 15.08.2017.
- Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), me vendimin nr. 10, datë 16.10.2017, ka miratuar me kusht lejen e ndërtimit të infrastukturës “Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë”, me subjekt zhvillues FSHZH, dokument i cili do të lëshohej vetëm pas:

- a. miratimit të VKM-së për shpronësimin e subjekteve, prona private e të cilëve, preket nga zbatimi i projektit, si dhe,
- b. pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër, dhe Vau i Dejës.

Vendimi nr. 10, datë 16.10.2017, i KKT-së rezulton i botuar në regjistrin e planifikimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), sikurse parashikuar në nenin 56, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar (ligj nr. 107/2014)², ndërsa Harta e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi nuk rezulton e botuar në këtë regjistër të AZHT-së;

- Pavarësisht lëshimit të lejes së ndërtimit me kusht sikurse cituar më sipër, nga i gjithë informacioni dhe dokumentacioni zyrtar i disponueshëm nga ana jonë, si dhe për shkak të mungesës së botimit të një akti të tillë zyrtar në regjistrin e AZHT-së, na nxjerr në konkluzionin se mungon “Leja e zhvillimit” e miratuar nga KKT³ për ndërtimin e infrastrukturës “Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë”, si një akt i nevojshëm i miratimit të së drejtës për zhvillim, në bazë të legjislacionit në fuqi;
- Me VKM-në nr. 600, datë 13.10.2021, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, ndryshuar me VKM-në nr. 234, datë 17.04.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, (VKM nr. 600/2021) është miratuar inventari i rrugëve shtetërore në pronësi të ARRSH-së, në të cilin bën pjesë dhe segmenti rrugor “Harku i Bërdicës-Velipojë (gjurma e re)”;
 - ARRSH nuk ka kryer veprimtari administrative apo gjyqësore për kundërshtimin e akt marrëveshjes datë 15.08.2017, të lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe FSHZH-së, apo kundër kryerjes së punimeve për rikonstruksionin e rrugës Shkodër-Velipojë, pjesë e të cilit është dhe Loti 1, (gjurma e re), në kushtet kur ky segment rrugor kombëtar administrohej dhe administrohet prej saj sipas legjislacionit në fuqi;
 - Nuk është zhvilluar veprimtari administrative për shpronësimin e subjekteve, prona e të cilëve është prekur nga ndërtimi i infrastrukturës “Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë”;

²² Neni 56, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 107/2014 parashikojnë: “Botimi në regjistër 1. Të gjitha projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin, përfshirë dokumentacionin shoqërues dhe vërejtjet apo propozimet gjatë bashkërendimit të planifikimit, janë të detyrueshme për botim, përveç atyre llojeve, të cilat:

a) përjashtohen me ligj;

b) janë akte të brendshme të një autoriteti kombëtar ose vendom;

c) janë akte ose dokumentacion shoqërues, botimi i të cilave ndolohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit...”.

³ Ky akt nuk rezulton të jetë botuar në regjistrin e AZHT-së në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 56, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, për rrjedhojë konsiderohet i panxjerrë prej organit kompetent.

- Mungesa e datës së dorëzimit të sheshit të ndërtimit si dhe fillimit të punimeve për ndërtimin e infrastrukturës “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”. Më konkretisht, Akt-Marrëveshja datë 15.08.2017, e lidhur midis Bashkisë Shkodër dhe FSHZH, nuk përcakton datë fillimi dhe përfundimi të punimeve të ndërtimit të infrastrukturës sipas projektit në fjalë. Sipas çertifikatës së marrjes së objektit në dorëzim nr. 901/2 prot, datë 04.06.2024, nënshkruar midis FSHZH dhe Bashkisë Shkodër, rezulton se, përfundimi i punimeve është kryer më datë 04.06.2024;
- Rezulton se data e përfundimit të punimeve ka qenë data 13.04.2021, ndërsa objekti është dorëzuar në vitin 2024. Më konkretisht, FSHZH në shkresën 782/1 prot, datë 28.03.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, pohon se: “... FSHZH në përfundim të punimeve dhe periudhës së garancisë së defekteve⁴ e) më datë 13.04.2021, ka kryer inspektimin e punimeve së bashku me përfaqësues të kontraktorit, supervizorit, kolaudatorit dhe Bashkisë Shkodër dhe është firmosur nga të gjitha palët Çertifikata e Marrjes Përfundimtare në Dorëzim e Objektit” dhe konfirmimit të Bashkisë Shkodër, në shkresën nr. 26664/1 prot, datë 03.12.2024, se Çertifikata në fjalë, ka nr. 901, datë 04.06.2024.
- Kryerja e punimeve për ndërtimin e infrastrukturës “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, me subjekt zhvillues FSHZH, është bërë pa u plotësuar kushtet e vendosura në lejen e ndërtimit me kusht të infrastrukturës prej KKT-së, leje e cila, sipas kushtit të vendosur në vendimin nr. 10, datë 16.10.2017, prej KKT-së, do të nxirrej/dorëzohej pas miratimit të shpronësimit të subjekteve, pasuria e të cilëve është prekur nga ndërtimi i Lotit 1, “*Harku i Bërdicës-Velipojë (gjurma e re)*”. Gjithashtu, konstatohet se është kryer heqja nga posedimi i pasurive të paluajtshme subjekteve pronare, pa u kryer më parë procedura e shpronësimit për interes publik.
- Loti 1, i projektit të ndërtimit infrastrukturor “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, është ndërtuar duke kaluar në gjurmë të re, dhe jo sipas rrugës ekzistuese, e cila ka qenë dhe është pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar dhe administrohet nga ARRSH, sipas VKM-së nr. 600/2021;
- Moskryerje e procedurave prej organeve shtetërore për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar subjekteve pronar nga data e heqjes nga posedimi i pasurive të tyre për ndërtimin infrastrukturor “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, e në vijim;
- Kalimi i pronësisë së segmentit rrugor (Loti 1) “*Harku i Bërdicës-Velipojë (gjurma e re)*”, tek ARRSH, me VKM-në nr. 600/2021 të ndryshuar, është i pavlefshëm për sipërfaqet e pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi infrastrukturor “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, për shkak të moszhvillimit të procedurave për shpronësimin e subjekteve deri më sot;
- Në Lotin 1, “*Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”, konstatohet mungesa e vijueshmërisë së vendosjes së guardreleve (mbrojtëseve metalike) sikurse

⁴ Sipas marrëveshjes datë 15.08.2017 periudha e garancisë së difekteve/punimeve është dy vite.

referuar nga media, dhe konfirmuar nga ARRSH-ja me shkresën 4958/2 prot., datë 23.07.2024, dhe fotot e vëna në dispozicion prej saj Avokatit të Popullit;

Përsa më sipër, në vlerësim të përgjigjeve të dhëna nga institucionet e sipërpërmendura, veprimtaria administrative e zhvilluar për ndërtimin infrastrukturor “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, (gjurma e re) nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë⁵, parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor⁶, si dhe respektimin e së drejtës të pronësisë⁷.

Sipas VKM-së më të hershme nr. 405, datë 08.01.1996, “*Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, është përcaktuar, midis të tjerave, se, segmenti rrugor kombëtar “*Harku i Bërdicës-Velipojë*”, është në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, Drejtorisë Rajonale të saj. Me krijimin e ARRSH-së, sipas ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “*Për Autoritetin Rrugor Shqiptar*”, menaxhimi i rrjetit rrugor shtetëror, në përputhje me Kodin Rrugor si dhe këtë ligj, i ka kaluar këtij organi. Pra, ARRSH, në përputhje me ligjin në fjalë ka marrë përsipër funksionet dhe përgjegjësitë që më parë i përkisnin Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Në procedurën e zhvilluar për ndërtimin infrastrukturor “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, ARRSH, në cilësinë e organit përgjegjës për administrimin e rrugëve kombëtare dhe implementimin e politikave të qeverisë për këtë sektor, rezulton të mos jetë përfshirë.

Nga hetimi administrativ i kësaj çështjeje ka rezultuar se, vendimi nr. 10, datë 16.10.2017, “*Për miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës “Rikonstruksioni i Rrugës Shkodër-Velipojë*”, është nxjerrë prej KKT-së, në kushtet e mungesës së vendimit për miratimin e lejes përkatëse zhvillimore, ndërkohë që nuk është zhvilluar procedura e shpronësimit publik të subjekteve, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i këtij projekti, Loti 1, segmenti “*Harku i Bërdicës- deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”.

Për ndërtimin e projektit publik “*Rikonstruksioni i Rrugës Shkodër-Velipojë*”, Loti 1, segmenti “*Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”, legjislacioni në fuqi parashikon, miratimin e akteve dhe dokumenteve në një proces të detajuar dhe me disa faza. Këto akte janë të lidhura me rregullat e administratës publike dhe legjislacionin për urbanizmin dhe ndërtimin. Disa nga aktet kryesore që miratohen janë Studimi i fizibilitetit projektimi arkitektonik dhe inxhinierik; Leja e ndërtimit - Kjo është një nga aktet më të rëndësishme për ndërtimin e çdo objekti publik. Leja e ndërtimit miratohet për rastin në fjalë nga KKT-ja dhe ka për qëllim të sigurojë që projekti të jetë në përputhje me planet urbanistike dhe rregullat e ndërtimit;

⁵ Neni 4 i ligjit nr. 44/2015 Kodi Procedurave Administrative”

⁶ Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: “... Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

⁷ Neni 41, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se: “1. E drejta e pronës private është e garantuar.

...

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë”.

vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM); Leja për ndotjen e ambientit; nëse është rasti miratimi nga institucionet përkatëse.

Ky proces ka për qëllim të sigurojë që projektet publike të jenë të sigurta, të qëndrueshme dhe të përputhshme me interesat e shoqërisë dhe mjedisit.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, leja zhvillimore, për ndërtimin e infrastrukturës “*Rikonstruksioni i Rrugës Shkodër-Velipojë*”, Loti 1, segmenti “*Harku i Bërdicës- deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”, është një dokument ligjor dhe administrativ⁸ që jep miratimin për realizimin e një ndërtimi të caktuar. Leja zhvillimore ka për qëllim të sigurojë që projekti është në përputhje me rregullat dhe planet urbanistike, si dhe me normat e sigurisë dhe të mjedisit.

Leja zhvillimore është një dokument i nevojshëm për të vlerësuar nëse projekti është në përputhje me rregullat dhe normat e zhvillimit të territorit, dhe për të siguruar që ndërtimi do të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe urbanistike. Vetëm pasi të merret kjo leje, mund të kërkohet leja e ndërtimit, që do të lejojë fillimin e punimeve.

Veprimtaria për ndërtimin e plotë të infrastrukturës “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, jo vetëm rezulton të jetë kryer në mungesë të miratimit të lejes zhvillimore, por edhe të moslëshimit të lejes së ndërtimit nr. 10, datë 16.10.2017, të KKT-së, referuar kushtit të paplotësuar për miratimin më parë të VKM-së për shpronësimin e subjekteve, pasuria e të cilëve preket nga ndërtimi i projektit “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”.

Vlerësimi i veprimtarisë administrative në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë në procesin e ndërtimit të infrastrukturës “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*” është një element shumë i rëndësishëm për të siguruar që proceset e administratës publike përmbushin kërkesat ligjore dhe rregullat që janë në fuqi. Ky parim kërkon që çdo veprim administrativ të jetë i bazuar në ligj dhe të respektojë të drejtat dhe liritë e individëve si dhe interesat e shoqërisë.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se, ndërtimi i infrastrukturës “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, nuk vjen në përputhje me ligje dhe akte nënligjore përkatëse, që lidhen me:

- ndërtimin dhe zhvillimin e projekteve publike⁹;
- mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtave të qytetarëve¹⁰;

Vlerësimi i veprimtarive të organit shtetëror në kushtet e mosrespektimit të të drejtës së pronës, siç është mosshpronësimi i saj ose heqja e nëdorësisë (ose dorëzimi i pronës pa procedura të rregullta), me rastin e ndërtimit të infrastrukturës “*Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Velipojë*”, ka pasoja serioze juridike, administrative dhe financiare.

⁸ Neni 3, pika 17 e ligjit nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, parashikon, se: “*Leje zhvillimi*” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.

⁹ Ligji nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*”, i ndryshuar, ligji nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, etj.

Përtej të tjerave nga tërë problematika e pasqyruar, evidentohet një keqadministrim i qartë në ndërveprimin e organeve të ndryshme të përfshira në këtë procedurë administrative

Mosrespektimi i së drejtës së pronës nga organi, shkel të drejtat e pronarëve të ligjshëm dhe procedurat e përcaktuara nga ligji, si:

1. Shkelje e Kushtetutës dhe konventave ku Shqipëria bën pjesë: Çdo veprim që ndikon në pronën private pa pasur një bazë ligjore, si për shembull mosshpronësimi pa kompensim të drejtë, konsiderohet një shkelje e të drejtës për të patur pronë të garantuar nga Kushtetuta dhe konventat ndërkombëtare si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
2. Kompensimi i Dëmshpërblimit: Përdorimi i pronës private nga shteti për projekte publike pa shpronësim të drejtë, sjell për pasojë detyrimin për të paguar kompensime të plota për dëmin që shkaktohet për pronarët, përfshirë shpenzimet për humbjen e përdorimit dhe vlerës së pronës.
3. Përgjegjësi e Organit Shtetëror: Për shkak të shkeljes së ligjeve dhe procedurave, organet shtetërore mbajnë përgjegjësi për shkeljet, dhe se, zhvillimi i procedurave disiplinore për dënime administrative ndaj personit përgjegjës është detyrim.

Në vlerësimin e këtyre veprimeve/qëndrimeve do të duhet të mbahet parasysh shkeljet e të drejtave të individëve, për përmirësimin e procedurave dhe masat që do të ndërmerren për të zgjidhur situatën.

Lidhur me, mungesën e sigurisë në qarkullimin rrugor të automjeteve në Lotin 1, “*Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”, për shkak të mosvendosjes në vijueshmëri të guardreleve (mbrojtëseve metalike), në të dy anët e segmentit rrugor, vjen në kundërshtim me standardet e parashikuara në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.

Fakti i mungesës së guardreleve vijuese në 24 pikat/pozicionet e përmendura nga media, nxjerrë nevojën e kryerjes së veprimeve/procedurave të caktuara administrative, sikurse parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligj, si dhe në rastin në fjalë, të shmangjes së rrezikut që vjen nga mosvendosja e tyre rregullisht prej subjektit ndërtues. Kjo situatë nuk mund të justifikohet nga ARRSH me deklaratimet/shpjegimet e dhëna Avokatit të Popullit. Mosmarrëveshjet administrative midis ARRSH-së me Bashkinë Shkodër dhe FSHZH, nuk mund të justifikojnë mosmarrjen e masave për garantimin e sigurisë në qarkullimin rrugor në segmentin në fjalë. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis ARRSH- së dhe Bashkisë Shkodër/FSHZH, kanë ekzistuar dhe ekzistojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pasojat. Konstatohet se, mjeti ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pretenduara prej ARRSH-së nuk është ushtruar, edhe pse kalimi në inventar i segmentit rrugor “*Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”, është kryer me VKM nr. 600, datë 13.10.2021, të ndryshuar.

Sa më sipër, ushtrimi i detyrave tuaja funksionale dhe marrja e masave të menjëhershme për garantimin e moscenimit të jetës dhe shëndetit, si dhe pasurisë së personave që frekuentojnë/përdorjnë segmentin rrugor “*Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit (gjurma e re)*”, përbën nevojë emergjente.

Sjellim në vëmendje, se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 21 të saj, sanksionon, se: *“Jeta e personit mbrohet me ligj”*, për rrjedhojë, organet e administratës publike, në respektim të këtij detyrimi, duhet të kryejnë veprimtari administrative e cila garanton jetën e personit, shëndetin dhe pasurinë e tij.

E drejta e jetës është një nga të drejtat themelore të individëve dhe është e garantuar nga shumë instrumente ndërkombëtare dhe kombëtare, përfshirë Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në kontekstin e administratës publike, ruajtja e jetës së individëve kërkon një seri masash që ndihmojnë në parandalimin e rreziqeve dhe në mbrojtjen efektive të jetës.

Mbrojtja e të drejtës së jetës nga rrezikshmëria në qarkullimin rrugor është një çështje shumë e rëndësishme dhe kërkon angazhim të përbashkët nga shteti, institucionet, shoqëria dhe individët. Qarkullimi rrugor ka lidhje të ngushta me jetën e njerëzve, dhe çdo lloj rreziku që mund të ndikojë në sigurinë e tij duhet të parandalohet dhe menaxhohet.

Mbrojtja e të drejtës së jetës përbën një nga parimet më të rëndësishme të çdo shoqërie. Rrezikshmëria që vjen nga mungesa e sigurisë rrugore është një problem që preokupon shumë shtetin tonë dhe që ka pasur pasoja të mëdha në humbjen e jetëve njerëzore, si dhe në dëmtimin e shëndetit të shumë individëve. Kjo përfshin si aksidente automobilistike, ashtu edhe ato që përfshijnë këmbësorë, motoristë, dhe përdorues të tjerë të rrugës.

Në lidhje me të drejtën e jetës, parimi i sigurisë rrugore është thelbësor për mbrojtjen e jetëve të qytetarëve. Ky parim kërkon krijimin dhe zbatimin e politikave, legjislacioneve dhe masave që rrisin sigurinë e qarkullimit rrugor dhe minimizojnë rrezikun e aksidenteve. Kjo mund të arrihet përmes krijimit të rrugëve të sigurta.

Shteti, autoritetet e tij, duhet të angazhohen vazhdimisht për të krijuar një mjedis të sigurt rrugor që mbrojtjen e jetës ta bëjë një prioritet dhe të sigurojë që individët të mund të qarkullojnë në mënyrë të sigurt dhe të mbrojtur nga rreziqet e mundshme.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe nxitjes së standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, gjen me vend të adresojë pranë autoriteteve kompetente zgjidhjen e çështjes së prezantuar, për arritjen e standardit të sigurisë në qarkullimin rrugor në segmentin kombëtar Harku i Bërdicës deri tek Kthesa e Daragjatit.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, konsideron se roli i institucioneve në evidentimin e problematikave dhe dhënien e zgjidhjeve duhet të jetë proaktiv e të garantojë njohjen e situatës në terren.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtroam, bazuar në nenin 63, paragrafi 3 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të*

së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”:

REKOMANDOJMË:

Vendosjen e menjëhershme nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të sinjalistikës së nevojshme paralajmëruese për drejtuesit e automjeteve si dhe këmbësorve, si masë emergjente për parandalimin e aksidenteve në daljet e segmentit rrugor Harku i Bërdicës-Kthesa e Darragjatit, deri në vendosjen e guardreleve (barrierave bllokuese/mbrojtëseve metalike) në këto dalje;

Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar për vendosjen e guardreleve (barrierave bllokuese/mbrojtëseve metalike) në daljet e segmentit rrugor Harku i Bërdicës-Kthesa e Darragjatit;

Rritjen efektive të bashkëpunimit midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bashkisë Shkodër, për identifikimin dhe adresimin e zonave të rrezikshme, me qëllim përmirësimin e sinjalistikës dhe kushteve të tjera infrastrukturore të cilat kontribuojnë në përmirësimin e sigurisë rrugore;

Kryerjen nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të veprimeve për shpronësimin për interes publik të pasurive, pronë private, të prekura nga ndërtimi i segmentit rrugor Harku i Bërdicës-Kthesa e Darragjatit (gjurma e re);

Kryerjen e veprimeve prej Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Shkodër, Autoritetit Rrugor Shqiptar, për shpërblimin e dëmit të shkaktuar pronarëve të pasurive, pronë private, të prekura nga ndërtimi i segmentit rrugor Harku i Bërdicës-Kthesa e Darragjatit (gjurma e re), në kushtet e cenimit të tagrit të nëdorësisë pa një proces të rregullt ligjor;

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të argumentuar të kryhet brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, sikurse parashikuar nëligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Me besim në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Erinda MELI